

**AK-INVEST sh.a**

**Pasqyrat Financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021  
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyrat Financiare të konsoliduara:	
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar	<b>3</b>
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse	<b>4</b>
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital	<b>5</b>
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Mjeteve Monetare	<b>6</b>
Shënime mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara	<b>7-39</b>

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Për drejtimin dhe aksionerët e Shoqërisë AK-Invest sh.a.

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë **AK-Invest sh.a.** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Drejtimin dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

**mazars**

Emin Duraku Str., Binjaket Build.,  
No.5, 1013, Tirana, Albania  
NUIŠ: K32123006W

---

**Diana Ylli (Golemi)**  
Auditues Ligjor

20 korrik 2022

**AK-Invest sha***(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2021**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<b>AKTIVE</b>			
Mjete monetare dhe të ngjashme	6	1,253,304,052	1,057,839,930
Investime të tjera afatshkurtra	7	83,423,986	83,950,677
Hua të dhëna klientëve	8	133,333,003	148,606,304
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	64,213,567	64,657,734
Të tjera të arkëtueshme Moneygram	10	159,920,782	178,847,642
Llogari të tjera të arkëtueshme	11	2,836,235	11,437,193
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	12	8,684,501	24,051,769
Aktive afatgjata materiale	13	114,765,534	119,454,561
Aktive afatgjata jomateriale	14	4,034,002	3,776,278
E drejtë përdorimi	15	5,971,824	10,179,705
Investime në shoqëri të tjera	16	7,500,000	7,500,000
<b>Totali i aktiveve</b>		<b><u>1,837,987,486</u></b>	<b><u>1,710,301,793</u></b>
<b>DETYRIMET</b>			
Qira financiare	17	5,713,185	10,228,854
Llogari të pagueshme tregtare	18	23,354,111	27,068,167
Të tjera të pagueshme për agjente	19	196,902,956	216,818,633
Grante dhe të ardhura të shtyra	20	390,267	187,962
Tatim mbi fitimin	21	19,595,095	6,781,827
Detyrime të tjera afatshkurtra	22	182,528,119	216,019,267
Garanci të marra afatgjata	23	57,090,082	49,753,743
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>485,573,815</u></b>	<b><u>526,858,453</u></b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar		1,018,896,487	958,202,900
Rezerva të përgjithshme		69,400,358	60,729,846
Rezerva përkthimi		351,079	166,491
Fitimi i ushtrimit		272,831,893	172,831,556
Fitim humbje të mbartura		(4,712,441)	(4,133,748)
Interesa të pakicës		(4,353,705)	(4,353,705)
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>24</b>	<b><u>1,352,413,671</u></b>	<b><u>1,183,443,340</u></b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b><u>1,837,987,486</u></b>	<b><u>1,710,301,793</u></b>

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 39 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare të konsoliduara.

**AK-Invest sha**
*(Vlerat janë në Lekë)*
**Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interes	25	8,287,563	12,546,541
Shpenzime për interes	26	(607,989)	(819,956)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>7,679,574</b>	<b>11,726,585</b>
Të ardhura nga komisionet	27	644,641,652	562,319,859
Shpenzime për komisionet	28	(222,091,117)	(181,435,628)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>422,550,535</b>	<b>380,884,231</b>
Rezultati neto nga këmbimet valutore	29	36,447,133	(24,226,044)
Të ardhura nga veprimtari të tjera operative	30	364,404	489,368
<b>Fitim/humbje neto nga veprimtari të tjera</b>		<b>36,811,537</b>	<b>(23,736,676)</b>
Provizione për humbje nga huatë	31	3,848,267	(17,240,391)
Shpenzime amortizimi	32	(19,571,665)	(18,078,933)
Shpenzime personeli	33	(62,945,594)	(52,988,016)
Shpenzime administrative	34	(64,623,067)	(75,743,001)
<b>Total</b>		<b>(143,292,059)</b>	<b>(164,050,341)</b>
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>323,749,587</b>	<b>204,823,799</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>35</b>	<b>(50,917,694)</b>	<b>(32,548,243)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(50,917,694)	(32,548,243)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>272,831,893</b>	<b>172,275,556</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		184,588	(11,944)
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>184,588</b>	<b>(11,944)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>273,016,481</b>	<b>172,263,612</b>
<b>Pronarit</b>		273,016,481	172,819,612
<b>Interesat e pakices</b>		-	(556,000)
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>273,016,481</b>	<b>172,263,612</b>

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 39 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare të konsoliduara.

## AK-Invest sh.a

(Vlerat janë në Lekë)

## Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva përktimi	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e akumuluar	Totali	Interesat jo kontrolluese	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2020</b>	<b>853,310,600</b>	<b>178,435</b>	<b>53,177,276</b>	<b>142,053</b>	<b>144,051,057</b>	<b>1,050,859,421</b>	<b>(3,797,705)</b>	<b>1,047,061,716</b>
Rritje kapitali	104,892,300	-	-	-	(104,892,300)	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(35,881,988)	(35,881,988)	-	(35,881,988)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	7,409,240	1,277	(7,410,517)	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	(11,944)	-	-	172,831,556	172,819,612	(556,000)	172,263,612
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020</b>	<b>958,202,900</b>	<b>166,491</b>	<b>60,586,516</b>	<b>143,330</b>	<b>168,697,808</b>	<b>1,187,797,045</b>	<b>(4,353,705)</b>	<b>1,183,443,340</b>
Rritje kapitali	60,693,587	-	-	-	(60,693,587)	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(104,046,150)	(104,046,150)	-	(104,046,150)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	8,670,512	-	(8,670,512)	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	184,588	-	-	272,831,893	273,016,481	-	273,016,481
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021</b>	<b>1,018,896,487</b>	<b>351,079</b>	<b>69,257,028</b>	<b>143,330</b>	<b>268,119,452</b>	<b>1,356,757,376</b>	<b>(4,353,705)</b>	<b>1,352,413,671</b>

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 39 janë pjesë përbërëse e kësaj Pasqyre Financiare të konsoliduara.

Këto Pasqyra Financiare të konsoliduara janë aprovuar nga Bordi Drejtues më \_\_\_\_\_ dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Znj. Suzana Adili  
Administratore

Orgeta Buha

Hartuese e Pasqyre Financiare të konsoliduara



**AK-Invest sh.a**
*(Vlerat janë në Lekë)*
**Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Mjeteve Monetare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	323,749,587	204,823,799
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Provizione për humbje nga huatë (neto)	(3,848,267)	17,240,391
Shpenzime amortizimi	19,571,665	18,078,933
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në hua të dhëna	19,121,568	(9,617,335)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	27,971,985	(70,873,333)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(57,120,881)	220,565,148
Rritje/(rënie) në garanci të marra dhe të ardhura të shtyra	7,538,644	9,943,575
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	15,367,268	(507,516)
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>352,351,569</b>	<b>389,653,662</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(38,104,426)	(32,159,875)
	<b>(38,104,426)</b>	<b>(32,159,875)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(10,510,072)	(5,775,054)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	-	342,501
Investime në depozita	526,691	(50,336,109)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(9,983,381)</b>	<b>(55,768,662)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(4,938,078)	(4,382,209)
Dividendë të paguar	(104,046,150)	(35,881,988)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>(108,984,228)</b>	<b>(40,264,197)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>195,279,534</b>	<b>261,460,928</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,057,839,930	796,390,946
Diferenca përkthimi	184,588	(11,944)
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>1,253,304,052</b>	<b>1,057,839,930</b>

**6**

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 39 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare të konsoliduara.



## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

AK-Invest sh.a (më poshtë "Shoqëria" ose "Dega") është një shoqëri aksionere me kapital shqiptar. Shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 10.03.2004 dhe është pajisur me NIPT K41516046D.

Objekti i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve të pagesave e arkëtimeve, ndërmjetësimi për transaksionet monetare (përfshirë valutat), ofrimi i shërbimit të kasave të sigurimit, shërbimi si agjent ose këshilltarë financiarë (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26 të Ligjit; "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria ofron të gjitha format e kredisë, shërbimin e këmbimit valutor dhe të gjithë shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave.

Shoqëria është licensuar në bazë të ligjit nr 96662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe rregullores "Për Licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendim nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me licencë nr. 07/1.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është 1,018,896,487 lekë dhe zotërohet nga aksionerët:

- Suzana Adili i cili zotëron 65% të aksioneve;
- Muharrem Kokona i cili zotëron 35% të aksioneve.

Administratore e Shoqërisë është Znj.Suzana Adili.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë:

- Z. Suzana Adili
- Z. Muharrem Kokona
- Znj. Almida Daiu
- Z. Elvin Meka

Selia e Shoqërisë është Rruga "Bardhok Biba", objekti "LID", Tiranë 1001.

Nr. i punonjësve në 31 dhjetor 2021 ka qenë 52 punonjës, (31 dhjetor 2020: 46 punonjës).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

### **2.2 Baza e matjes**

Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **2.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat Financiare të konsoliduara të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto Pasqyra Financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

### 2.5 Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zotërojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuar ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqërive të grupit, balancat dhe fitimet e porealizuara për transaksione ndërmjet shoqërive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e porealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qenë e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

### 2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare të konsoliduara kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### 2.6.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

##### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivitetet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivitetet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

(Vlerat janë në Lekë)

## 2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

### 2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

#### 2.6.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

*Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme*

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes së këtyre testimeve shoqëria merr parasysh pagesat e rregullta të bëra, pra debitori, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arkëtueshmërinë e pagesave nga instrumentat financiare dhe një numër kriteresh të tjera të përdorura për të vlerësuar arkëtueshmërinë.

#### 2.6.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## 3. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

### 3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2

### 3.2 Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Kontratat me kushte – Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) – Në fuqi nga 1 janari 2022
- Aktive afatgjatë materiale: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3). Në fuqi nga 1 janari 2022
- Dhënia e shënimeve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

#### 4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në Pasqyrat Financiare të konsoliduara.

##### 4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet monetare të emetuara në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhë funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit. Zërat jo monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk konvertohen.

Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR	120.76	123.70
USD	106.54	100.84

##### 4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiarë – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

(Vlerat janë në Lekë)

#### 4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

**Aktivet financiare – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësisia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkëlqje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar (“aktivi fillestar”), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t’ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, hua nga klientet, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut.

*(Vlerat janë në Lekë)*

#### **4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)**

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

##### **4.3 Njohja e te ardhurave**

###### *Të ardhurat nga interesat*

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit me përjashtim të arkëtueshmëve afatshkurtra ku njohja e interesit do të jetë imateriale. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, institucioni vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhme duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me koston e amortizuar në bazë të interest efektiv.

###### *Të ardhurat nga komisionet*

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet janë shkaktuar nga shërbimet financiare të ofruara nga Shoqëria. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet njihen në kohën kur ofrohet shërbimi. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose pasiv financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

*(Vlerat janë në Lekë)***4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****4.4 Aktive afatgjata materiale***Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

*Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

*Ç'regjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.5 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

##### 4.6 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.



#### 4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.6 Aktivet Afatgjata Jomateriale (vazhdim)

###### *Mbajtja e mëpasshme*

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

##### 4.7 Provizonet

Një provigjon njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet janë përcaktuar duke iu zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

##### 4.8 Fondet për pensione

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit, sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumën të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim përfitimi të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

##### 4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatuueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohëshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

(Vlerat janë në Lekë)

#### 4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së Pasqyrave Financiare të konsoliduara, Drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

##### 4.11 Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në Pasqyrat Financiare të konsoliduara. Ato paraqiten në shënime të Pasqyrave Financiare të konsoliduara për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në Pasqyrat Financiare të konsoliduara por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

##### 4.12 Garancitë financiare dhe angazhimet e huave

Garancitë financiare janë kontrata të cilat i lejojnë Institucionit të kryej pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin në rast humbjeje, kur një debitor nuk arrin të shlyejë huanë në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit. Angazhimet e huasë janë angazhime të cilat ofrojnë kredi me kushte dhe terma të paracaktuar.

Detyrimet që rrjedhin nga garancitë financiare apo angazhime për të siguruar një hua me normë interesi më të ulët se niveli i tregut maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet përgjatë jetës së garancisë apo angazhimit. Detyrimi vlerësohet me vlerën më të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të çdo pagese që pritët të shlyhet në bazë të kontratës.

#### 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

##### *Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

*(Vlerat janë në Lekë)***5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)***Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale*

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

*Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")*

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

*Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë*

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

**6. MJETE MONETARE DHE TË NGJASHME**

Balanca e mjeteve monetare dhe të ngjashme të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në arkë	157,593,854	92,296,071
Llogari rrjedhëse në banka	1,095,710,198	965,543,859
	<u><b>1,253,304,052</b></u>	<u><b>1,057,839,930</b></u>

**7. INVESTIME TË TJERA**

Investimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Depozita me afat në banka	67,898,871	73,569,765
Investim në fond investimi	15,000,000	10,000,000
Interesa të llogaritura për depozitat me afat	525,115	380,912
	<u><b>83,423,986</b></u>	<u><b>83,950,677</b></u>

*(Vlerat janë në Lekë)***8. HUA TË DHËNA KLIENTËVE**

Huatë e dhëna klientëve më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Hua me afat	86,755,555	104,322,991
Linja kredie	87,646,475	89,605,450
<b>Vlera bruto</b>	<b>174,402,030</b>	<b>193,928,441</b>
Zbritje nga zhvlerësimi	(41,069,027)	(45,322,137)
	<u><b>133,333,003</b></u>	<u><b>148,606,304</b></u>

*Lëvizjet në provizionet për zhvlerësimin e huave:*

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<b>Gjendja në fillim të periudhës</b>	45,322,137	32,046,823
Zhvlerësimi për huatë për periudhën	4,703,541	41,896,649
Rimmarje për vitin	(8,956,651)	(28,621,335)
<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<u><b>41,069,027</b></u>	<u><b>45,322,137</b></u>

**9. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE**

Balanca e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogari të arkëtueshme nga Moneygram	54,052,919	47,213,435
Llogari të arkëtueshme nga OSHEE	7,999,760	15,108,569
Llogari të arkëtueshme nga Ujësjelles Kanalizime	358,062	314,456
Llogari të arkëtueshme nga të tjerë	1,802,826	2,021,274
	<u><b>64,213,567</b></u>	<u><b>64,657,734</b></u>

**10. TË TJERA TË ARKËTUESHME MONEYGRAM**

Balancat e llogarive të arkëtueshme nga MoneyGram më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të arkëtueshme për transfertat nga Moneygram	159,920,782	178,847,642
	<u><b>159,920,782</b></u>	<u><b>178,847,642</b></u>

*(Vlerat janë në Lekë)***11. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME**

Në këtë zë janë paraqitur llogaritë për garanci dhe të tjera llogari të arkëtueshme, balanca e të cilave më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogari për garanci	2,801,235	2,375,053
Llogari të tjera të arkëtueshme	35,000	9,062,140
	<u><b>2,836,235</b></u>	<u><b>11,437,193</b></u>

**12. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	1,771,747	3,436,771
Paradhënie për rimbushje e-top up	4,289,254	2,245,797
Paradhënie për abonime Tring	1,353,572	875,029
Paradhënie për dividend ndaj aksionerëve	-	15,547,263
Paradhënie për punonjës	1,269,928	1,946,909
	<u><b>8,684,501</b></u>	<u><b>24,051,769</b></u>

## AK-Invest sh.a

## Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lekë)

## 13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	Ndërtesa	Instalime teknike	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
<b><i>Kosto</i></b>							
Gjendja më 1 janar 2020	135,664,141	4,279,416	15,307,804	15,313,793	27,094,600	3,360,379	201,020,133
Shtesa	-	-	-	1,298,932	806,296	-	2,105,228
Pakësime	-	-	(7,065,451)	-	-	-	(7,065,451)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>135,664,141</b>	<b>4,279,416</b>	<b>8,242,353</b>	<b>16,612,725</b>	<b>27,900,896</b>	<b>3,360,379</b>	<b>196,059,910</b>
Shtesa	-	47,524	571,473	2,769,820	1,122,284	95,000	4,606,101
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>135,664,141</b>	<b>4,326,940</b>	<b>8,813,826</b>	<b>19,382,545</b>	<b>29,023,180</b>	<b>3,455,379</b>	<b>200,666,011</b>
<b><i>Amortizimi i akumuluar</i></b>							
Gjendja më 1 janar 2020	29,810,117	3,301,357	12,436,825	11,127,946	14,681,376	1,931,508	73,289,129
Amortizimi i vitit	5,292,701	195,612	547,850	1,122,039	2,595,194	285,774	10,039,170
Kthim amortizimi	-	-	(6,722,950)	-	-	-	(6,722,950)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>35,102,818</b>	<b>3,496,969</b>	<b>6,261,725</b>	<b>12,249,985</b>	<b>17,276,570</b>	<b>2,217,282</b>	<b>76,605,349</b>
Amortizimi i vitit	5,028,066	165,202	424,699	1,314,982	2,131,976	230,203	9,295,128
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>40,130,884</b>	<b>3,662,171</b>	<b>6,686,424</b>	<b>13,564,967</b>	<b>19,408,546</b>	<b>2,447,485</b>	<b>85,900,477</b>
<b><i>Vlera neto kontabël</i></b>							
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>100,561,323</b>	<b>782,447</b>	<b>1,980,628</b>	<b>4,362,740</b>	<b>10,624,326</b>	<b>1,143,097</b>	<b>119,454,561</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>95,533,257</b>	<b>664,769</b>	<b>2,127,402</b>	<b>5,817,578</b>	<b>9,614,634</b>	<b>1,007,894</b>	<b>114,765,534</b>

(Vlerat janë në Lekë)

**14. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE**

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	AAJM	Total
<b><i>Me kosto</i></b>		
Gjendja më 1 janar 2020	17,710,874	17,710,874
Shtesa	1,165,401	1,165,401
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>18,876,275</b>	<b>18,876,275</b>
Shtesa	1,224,778	1,224,778
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>20,101,053</b>	<b>20,101,053</b>
<b><i>Amortizimi</i></b>		
Gjendja më 1 janar 2020	14,122,946	14,122,946
Amortizimi i vitit	977,051	977,051
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>15,099,997</b>	<b>15,099,997</b>
Amortizimi i vitit	967,054	967,054
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>16,067,051</b>	<b>16,067,051</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2020</b>	<b>3,776,278</b>	<b>3,776,278</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2021</b>	<b>4,034,002</b>	<b>4,034,002</b>

**15. E DREJTA E PËRDORIMIT**

Lëvizjet e aktiveve në përdorim për vitin 2021 paraqiten si më poshtë:

	Ndertesa	Total
<b><i>Me kosto</i></b>		
Gjendja më 1 janar 2020	20,750,595	20,750,595
Shtesa	2,504,425	2,504,425
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>23,255,020</b>	<b>23,255,020</b>
Shtesa	4,679,193	4,679,193
Pakësime	(7,952,061)	(7,952,061)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>19,982,152</b>	<b>19,982,152</b>
<b><i>Amortizimi</i></b>		
Gjendja më 1 janar 2020	6,012,603	6,012,603
Amortizimi i vitit	7,062,712	7,062,712
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>13,075,315</b>	<b>13,075,315</b>
Amortizimi i vitit	9,309,483	9,309,483
Kthim amortizimi	(8,374,470)	(8,374,470)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>14,010,328</b>	<b>14,010,328</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2020</b>	<b>10,179,705</b>	<b>10,179,705</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2021</b>	<b>5,971,824</b>	<b>5,971,824</b>

*(Vlerat janë në Lekë)***16. INVESTIME NË SHOQËRI TË TJERA**

Në këtë zë detajohen investimet në shoqëri të tjera, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Investime në ASLE	7,500,000	7,500,000
	<u><b>7,500,000</b></u>	<u><b>7,500,000</b></u>

**17. QIRA FINANCIARE**

Në këtë zë detajohen qiratë financiare, balanca e të cilave më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime afatshkurtra të qirasë financiare	3,600,522	7,032,542
Detyrime afatgjata të qirasë financiare	2,297,658	3,381,307
Paradhënie për qira	(184,995)	(184,995)
	<u><b>5,713,185</b></u>	<u><b>10,228,854</b></u>

**18. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogari të pagueshme ndaj agjentëve	19,021,972	21,218,643
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe të tjera	4,079,259	5,475,097
Llogari të pagueshme ndaj ndërmjetësve	252,880	374,427
	<u><b>23,354,111</b></u>	<u><b>27,068,167</b></u>

**19. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME PËR AGJENTË**

Llogaritë e tjera të pagueshme për agjentët më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrim për transfertat ndaj agjentëve	188,377,312	209,316,178
Të tjera detyrime	8,525,644	7,502,455
	<u><b>196,902,956</b></u>	<u><b>216,818,633</b></u>



*(Vlerat janë në Lekë)***20. GRANTE DHE TË ARDHURA TË SHTYRA**

Grantet dhe të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të ardhura të papërfituara e-top up	390,267	187,962
	<b><u>390,267</u></b>	<b><u>187,962</u></b>

**21. TATIM MBI FITIMIN**

Tatimi mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Tatim mbi fitimin	19,595,095	6,781,827
	<b><u>19,595,095</u></b>	<b><u>6,781,827</u></b>

**22. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA**

Detyrimet e tjera afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime ndaj MoneyGram	120,760,000	123,700,000
Detyrime ndaj aksionerve	22,536,239	1,421,883
Detyrime ndaj të tretëve për këmbime valutore	15,163,663	66,604,388
Detyrime ndaj institucioneve për utilitete	15,160,272	14,861,186
Detyrime të tjera	5,863,966	6,921,772
Detyrime tatimore	2,131,875	1,906,826
Detyrime për paga	912,104	603,212
	<b><u>182,528,119</u></b>	<b><u>216,019,267</u></b>

*Detyrimet tatimore detajohen si më poshtë:*

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,175,553	688,031
Tatimi në burim	-	373,024
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	953,772	843,222
TVSH e pagueshme	2,550	2,549
	<b><u>2,131,875</u></b>	<b><u>1,906,826</u></b>